



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV
Sesioni vjeshtor

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike
Mbledhja nr. 23
Prishtinë, më 13 nëntor 2013, në orën 10:00, sala S-II
Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës

P R O C E S V E R B A L
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR MBIKËQYRJEN E FINANCEVE PUBLIKE

Në mbledhje morën pjesë: Ali Sadriu, Ramiz Lladrovci, Mursel Haljilji, Valbona Dibra, Adem Grabovci, Afrim Hoti dhe Albert Kinolli.

Munguan: Imri Ahmeti, Bali Muharremaj.

I ftuar: Lars Lage Olofsson, auditor i përgjithshëm, Ferid Agani, ministër i Shëndetësisë, Njazi Gashi-QKUK, Arianit Jakupi-AKPM.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Fatime Qorri, koordinatore e Komisionit, Mehmet Simnica zyrtar i fushës në Komision dhe Saranda Kelmendi, praktikante.

Mbledhjen e kryesoi: Ali Sadriu, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 22.10.2013;
3. Shqyrtimi i Raportit të Auditimit të pasqyrave vjetore financiare të Ministrisë së Shëndetësisë, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2012;
4. Shqyrtimi i Raportit të auditimit mbi menaxhimin e mbeturinave medicinale;
5. Shqyrtimi i Raportit të Auditimit të menaxhimit të prokurimit në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2012;
6. Shqyrtimi i Raportit të Auditimit për sistemin e menaxhimit financiar dhe kontrolleve në Agjencinë Kosovare për Produkte Medicinale, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2012;
7. Të ndryshme.

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës;

Kryetari konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, njëzëri miratoi rendin e ditës pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Komisionit, të mbajtur më 22.10.2013

Kryetari konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike e miratoi njëzëri, pa vërejtje, procesverbalin e mbledhjes së Komisionit, të mbajtur më 22 tetor 2013.

3. Shqyrtimi i Raportit të Auditimit të pasqyrave vjetore financiare të Ministrisë së Shëndetësisë, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2012

Kryetari- Sipas këtij auditimi, MSH ka opinionin e pakualifikuar në theksim të çështjes, kjo për shkak të gabimeve në PVF si dhe mos paraqitja e drejtë e stoqeve për spitalet regjionale të Pejës dhe të Gjakovës. Vitin e kaluar ZAP-i, ka dhënë 12 rekomandime. Nga kjo MSH-ja ka adresuar 2 rekomandime plotësisht, 4 rekomandime janë adresuar pjesërisht, 6 rekomandime nuk janë adresuar fare. MSH-ja ka laramani të financimit, si nga grandit qeveritar, të hyrat vetjake si dhe një pjesë e mjeteve sigurohet nga donacionet. Marr në përgjithësi nga ndarja buxhetore prej 92.5 milionë euro për vitin 2012, MSH-ja ka shpenzuar 87.3 milionë euro, apo 94 % e të buxhetit vjetor në total të kategorive ekonomike.

Pjesa me e madhe e shpenzimeve i takon pagave dhe mëditjeve, rreth 46 %. Ndërsa, edhe në buxhetin kapital nuk kishte shfrytëzim racional të buxhetit, vetëm në tremujorin e fundit është shpenzuar 54 % e buxhetit, reflekton vonesa procedurale - leje ndërtimi (kërkesat nuk ishin parashtruar me kohë), revidimi i projekteve kapitale, si dhe mungesa e kapaciteteve profesionale për përcjelljen e të gjitha projekteve në zhvillim.

MSH-ja po ashtu realizon të hyra vetjake nga participimet, licencat, banderolat dhe bashkëpagesat nga shërbimet shëndetësore. Shuma e mjeteve të mbledhura gjatë vitit 2012, arrin në 3.95 milion euro. Në krahasim me vitin 2011, kishte rritje të hyrave për shkak të rritjeve të aktiviteteve shëndetësore si dhe shtim të aprovimeve për licenca dhe leje të importeve për produkte dhe pajisje mjekësore. Evidencat për të hyrat nga banderolat në Agjencinë Kosovare të Produkteve Mjekësore (AKPM) tregojnë se gjatë vitit 2012 AKPM-ja, nuk kishte mbajtur evidenca të sakta për të hyrat si dhe nuk kishte bërë barazimet e rregullta me pasqyrat e bankave. Procedurat e prokurimit; janë identifikuar një numër i dobësive në procedurat e prokurimit duke përfshirë: kontrata për dizajnimin e projektit “Ndërtimi i Rezervarit të Ujit të Pijshëm” në SR i Prizrenit (vlera e kontratës së ndërtimit ishte 92,141€), ishte mbështetur vetëm në marrëveshje gojore e jo me kontratë. Nënshkrimi i kontratave- Më 21/06/2011, MSH kishte lidhur kontratë afatgjatë, me dy OE për të njëjtin produkt (Cefriaxone 250 mg/ml). Për nga çmimi, ofertat ishin të barabarta dhe sipas ligjit ekzistues, vendimi për ofertat do të duhej të merrej në bazë të performancës në të kaluarën. Përveç kësaj sasia e parashikuar e furnizimit vjetor me këtë artikull ishte 7.000 njësi, mirëpo, furnizimi ishte bërë me 10.000 njësi, nga njëri OE kontraktues.

Me 29.8.2012, SR i Prizrenit, kishte nënshkruar kontratën për furnizimin me pajisje të teknologjisë informative, në vlerë prej 7,691€, gjë që ishte bërë pas faturimit. Në mungesë të Raportit të Pranimit, e tërë shuma ishte paguar ditën e njëjtë, derisa fatura ishte e datës 28.8.2012.

Realizimi i kontratave – MSH-ja ishte furnizuar me penj kirurgjik që nuk kanë qenë në përputhje me specifikimet e kontratës. Vlera e këtij furnizimi ishte 116,352€. Pagesat për këto produkte fillimisht ishin shty me arsyetimin se të njëjtat nuk janë konform kontratës. Mirëpo, këto produkte ishin të domosdoshme për operacione, prandaj furnizimi është përdorur dhe është paguar më vonë. Nga kodet e dy projekteve në SR të Prizrenit, janë paguar mjete për një projekt tjetër. Kjo është bërë pa aplikuar procedurat për transferim të mjeteve. Pagesat për kontratën “Furnizim me material administrativ”, kishin tejkaluar vlerën e kontratës për 2,130€.

(kontrata ishte 9,475€, ndërsa totali i pagesave 11,605€). Pagesa të bëra gabimisht- Janë identifikuar pagesa të bëra jashtë kërkesave kontraktuale pa dëshmi mbështetëse apo që janë të regjistruara në kode të gabueshme ekonomike. Në veçanti: Në muajin dhjetor MSH-ja kishte paguar paradhënie prej 22,296 €. Kjo shumë paraqet 10 % të vlerës së kontratave, andaj është në kundërshtim me Ligjin e Buxhetit dhe me rregulloren për mbylljen e vitit fiskal. MSH-ja dhe SR i Gjakovës kishin kryer pagesa para ofrimit të shërbimeve. MSH-ja kishte paguar 9,900 € për pozicione, të cilat ishin përfunduar 3 muaj më vonë.

Pagesa për trajnime, pa nënshkruar paraprakisht kontratë - Kontrata për mbajtjen e trajnimeve ishte nënshkruar pas përfundimit të tyre. Vlera e saj ishte 11,667 €. Pos kësaj, për njërin nga zyrtarët që merrte pjesë në trajnim, nuk ishte bërë paraprakisht kërkesa për trajnim edhe pse kjo është një kërkesë ligjore.

Evidencat dhe autorizimi i kujdestarive - janë shqyrtuar pagesat e kujdestarive për mjekët specialistë në klinikat të cilat kanë vëllim të madh të punës dhe në të cilat ofrohen shërbime 24 orë. Në klinikën e Gjinekologjisë (4 raste), të Radiologjisë (11 raste) dhe në Klinikën e Emergjencës (18 raste), kishte mospërputhje mes evidencave të nxjerra nga Libri i Kujdestarive dhe pagesave që iu janë bërë këtyre specialistëve.

Në repartet e SR të Gjakovës, nuk janë mbajtur ditarët për regjistrimin e kujdestarive. Orari përcaktohet nga drejtori i repartit dhe në bazë të atij orari, procedohet lista për pagesë. SR i Gjakovës po ashtu përdor alternativën e pagesës së gatishmërisë, mirëpo, kjo nuk ishte e rregulluar me ndonjë vendim të menaxhmentit të Spitalit.

Në disa klinika (QKUK) dhe reparte (Spitalet Regjionale) autorizimin e kujdestarive, e bëjnë shefat e klinikave-reparteve, të cilët janë staf shëndetësor dhe janë duke i autorizuar pagesat e tyre në mënyrë efektive. Kalkulim jo konsistent i kujdestarive- Kalkulimi i pagesave të kujdestarive rregullohet me Kontratën Kolektive (KK), të lidhur në mes të ministrit dhe Federatës së Sindikalistëve Shëndetësorë. Kontrata si bazë të përlllogaritjes ka 174 orë pune për muaj, dhe mbi këtë fond të orëve, është bërë kalkulimi i çmimore.

Në bazë të vendimit të Sekretarit të Përgjithshëm nr. 72/07/2011, të datës 13.07.2011 është nxjerrë Udhërrëfyesi mbi formën e zbatimit të KK-së në sektorin e shëndetësisë. Nuk është përdorur një bazë e njëtrajtshme e llogaritjes së kujdestarive nëpër institucionet shëndetësore. Për shembull, QKUK-ja përdorë 176 orë, ndërsa SR i Prizrenit përdor 176 dhe 184 orë, (varësisht nga ajo se sa ditë ka muaji).

Mungesa e barazimeve financiare me spitalet ku trajtohen pacientët e PTMJIPSH- Ministria subvencionon trajtimin mjekësor në institucionet shëndetësore private. Pas trajtimit mjekësor pacientët nuk sjellin ndonjë dokument-faturë për të dëshmuar nëse është kryer trajtimi dhe nëse mjetet janë përdorur për qëllimet e synuara apo kanë qenë në harmoni me paralogaritë fillestare. Kjo ndodh te rastet që trajtohen jashtë vendit. - Regjistri i pasurive të MSH-së- Në mes të regjistrit gjithëpërfshirës të pasurive dhe regjistrave individual të njësitë e MSH-së ekzistojnë dallime.

Menaxhimi i detyrimeve- Në Spitalet Regjionale nuk janë menaxhuar mirë dhe nuk janë raportuar me kohë obligimet e papaguara. Si rezultat i kësaj niveli i detyrimeve të pashlyera është rritur në masë të madhe. Krahësuar me PVF-të të vitit paraprak, ekziston një rritje prej 547,937 €. Për të gjitha këto çështje të ngritura kisha kërkuar sqarim nga ana e ministrit të shëndetësisë dhe Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm.

Lage Olofsson, Auditor i Përgjithshëm - Mënyra e organizimit të ri të sistemit shëndetësor, e ka shtyrë ZAP-in që të ketë fokus të veçantë në Auditimin e QKUK-së dhe të AKPM-së. Po ashtu decentralizimi i buxhetit në furnizim me barna të spitaleve regjionale është një nga reformat në sistemin shëndetësor. Problemet më të mëdha në sektorin e shëndetësisë janë menaxhimi i prokurimit. ZAP është munduar që përmes këtyre raporteve t'i paraqes vërejtje dhe rekomandimet.

Afrim Hoti- Pyeti lidhur me mungesën e barazimeve financiare me spitalet ku trajtohen pacientët e PTMJIPSH - Ministria subvencionon trajtimin mjekësor në institucionet

shëndetësore private. Pas trajtimit mjekësor pacientët nuk sjellin ndonjë dokument-faturë për të dëshmuar nëse është kryer trajtimi dhe nëse mjetet janë përdorur për qëllimet e synuara apo kanë qenë në harmoni me paralogaritë fillestare. Kjo ndodh te rastet që trajtohen jashtë vendit. Po ashtu mungesë e një softueri për të hyrat- Sistemet ekzistuese manuale për regjistrimin e të hyrave në QKUK dhe Spitalet Regjionale, kanë dobësi të kontrolleve. Për shembull, mungesa e evidencave për pagesat nga pacientë në protokolle, në disa klinika sugjeron që të hyrat e regjistruara nuk janë të sakta, pasi ka dallime në mes të dëftesë-pagesave dhe të dhënave nëpër protokolle. Pse MSH-ja nuk ka blere një softuer për të lehtësuar punën e regjistrimit të të hyrave nëpër ISH?

Ramiz Lladrovci- Pyeti se nga rekomandimet e një viti paraprak ka dalë se janë dhënë 12 rekomandime në total për MSH-në dhe sipas raportit vërehet se vetëm 2 janë adresuar, ndërsa 4 prej tyre janë në proces të adresimit dhe 6 rekomandime të tjera nuk janë adresuar fare. Cilat janë arsyet e mos zbatimit të rekomandimeve nga ana e MSH-së? Po ashtu çështja e shpenzimit të buxhetit kapital është e ulët, e me keq ky shpenzim mbi 54 % është në tre mujorin e fundit të vitit 2012.

Sipas të dhënave të ZAP-it, problem në vete është edhe mosbarazimi i të hyrave nga banderolat: gjatë vitit 2012, AKPM-ja nuk kishte mbajtur evidencë të saktë për të hyrat si dhe nuk kishte bërë barazimet e rregullta me pasqyrat e bankave. Për vendimmarrje dhe qëllim të raportimit është mbështetur në shënimet e SIMFK-së, prandaj nuk i ka adresuar variacionet në mes të të hyrave të ngarkuara dhe atyre të mbledhura. Shënimet e thesarit tregojnë që të hyrat nga banderolat për vitin 2012 ishin 117.771 € (që tregojnë se janë shitur 16.824,565 njësi banderolash), përderisa zyra për banderola thotë se ishin shtypur 22.231,917 banderola, që janë barazi me të hyra prej 155.622 €, një diferencë prej 37.851 € apo 32 % e të hyrave të pranuar.

Valbona Dibra- Theksoi se të gjeturat e ZAP-it janë pothuajse të ngjashme me ato të institucioneve të tjera, si në fushën e prokurimit, menaxhimit financiar dhe kontrollit, regjistrim të pasurisë në shpenzime etj. Opinioni i auditimit është i pakualifikuar në theksim të çështjes dhe se theksimi i çështje është dhënë për shkak gabimeve në PVF. Unë nga këtu do të rekomandoja që të bëhet një auditim i performancës për MSH-në me kusht që të shihet qartë se si shfrytëzohen resurset njerëzore brenda vetë spitaleve regjionale. Po ashtu, këtë auditim mund ta bëjnë ekspertë –auditorë, që kanë njohuri nga fusha e shëndetësisë, kjo në fakt do të na ndihmojë në dhënien e rekomandimeve profesionale nga fusha e shëndetësisë.

Ferid Agani, ministër i shëndetësisë - Adresimi i rekomandimeve të dhëna nga ZAP-i, kanë të bëjnë me QKUK-n-në, AKPM-në dhe MMM-në. Zbatimi i rekomandimeve nuk ka mundur të bëhet për shkak se një pjese e stafit menaxhues të MSH-së, që janë përgjegjës për zbatim të rekomandimeve, tani e disa muaj janë si ushtrues detyre në këto pozita. Po ashtu mungesa e fondeve për këtë sektor, ka rezultuar me moszbatim të plotë të këtyre rekomandimeve.

Ramiz Lladrovci- Plani i veprimit i dorëzuar nga ana e juaj nuk tregon se zbatimi i rekomandimeve është duke shkuar në drejtim të adresimeve. Nuk mund të jete stafi përgjegjës për moszbatim të rekomandimeve. Ju jeni përgjegjës për adresim të rekomandimeve.

Ferid Agani, ministër i shëndetësisë - Mosshpenzimi i buxhetit në shkallë të dëshirueshme është bërë për shkak të vonesave dhe problemeve të shumta me prokurim, dhe mendoj se më mire është që buxheti të shkojë në suficit se sa të harxhohet jashtë procedurave të parapara me ligjet në fuqi.

Ne jemi duke u munduar që të bëjmë një sistem komplet të ri shëndetësor, dhe nëse kjo nuk ndodhë vetëm do të kemi riciklim të problemeve në tërë sistemin shëndetësor. Zgjidhja këtu është vetëm në rformatizim të sistemit shëndetësor. Banka Botërore është duke na mbështetur për reformën shëndetësore, dhe shumë partnerë të tjerë nga mbar bota.

Gani Shabani, sekretar i MSH-së - Një pjesë e konsideruar e rekomandimeve janë në zbatim e sipër e veçanërisht ato që kanë të bëjnë me fushën e prokurimit publik. Po ashtu rekomandimi për barazim të të hyrave është zbatuar në përpikëri. Po ashtu kalkulimi jo konsistent i kujdestarive është në zgjidhje e sipër. Për të gjitha rekomandimet është përcaktuar koha dhe personat përgjegjës për adresim të rekomandimeve.

Ferid Agani, ministër i shëndetësisë - Vetëm brenda muajit të kaluar në QKUK, janë vendosur mbi 60 stenda në zemër për pacientë, që është me shumë se që janë vendosur për 7 vite të kaluara. Po ashtu keni të drejt kur ngritët çështjen e trajtimit të pacientëve jashtë institucioneve publike shëndetësore. Kjo deri tani është bërë vetëm me një marrëveshje të mirëkuptimit, mirëpo, nuk ka pasur procedura të prokurimit për përzgjedhjen sipas proceduarave që jep LPP. Mbi 200 punëtorë janë të angazhuar në klinika private shëndetësore dhe mendoj se kjo është mirë për ekonominë e vendit.

Çështja e prokurimit të vaksinave bëhet përmes proceduarve të prokurimit dhe ekziston bashkëpunimi me UNICEF-in. Është e vërtetë se ka pasur raste kur vaksinat kanë shkuar në spitalet regjionale pa u regjistruar fare në barnatoren qendrore, mirëpo nga momenti i dhënies së rekomandimit nga ZAP-i, kjo çështje tani është rregulluar dhe tani ky rekomandim është zbatuar plotësisht. Po ashtu tek kujdestaritë janë nxjerrë rregullore për çështjen e regjistrimit dhe pagesë së kujdestarit.

Arianit Jakupi- Furnizimi me barna është bërë nga Agjencia Kosovare për Produkte Medicinale për tërë rrjetin e sistemit publik shëndetësor. Po ashtu çështja e banderolave është problem në vete. Lidhur me këtë jemi munduar të marrim të gjitha masat që mos të ketë dallime në mes të hyrave që gjeneron sistemi për prodhim të banderolave dhe shumës së mjeteve të krijuara nga shitja e banderolave.

Ukshin Vllasa- MSH-ja ka hartuar planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve, mirëpo në disa raste, zbatimi i plotë i rekomandimeve merr kohë më të gjatë. MSH-ja është në rrugë të mirë për adresimin e këtyre rekomandimeve.

4. Shqyrtimi i Raportit të Auditimit të menaxhimit të prokurimit në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2012

Kryetari- Dobësitë më të mëdha janë në fushën e prokurimit edhe atë: prokurime të zhvilluara pa deklaratën e disponueshmërisë së fondeve. AK-ja do të iniciojë një aktivitet të prokurimit pasi të ketë kryer një vlerësim formal të nevojave, pse saktësisht nevojitet prokurimi. Plotësimi i formularit standard “Deklarata e nevojave dhe përcaktimi i disponueshmërisë së fondeve (DNPDP)” bëhet me qëllim të konstatimit të nevojave dhe disponimit të fondeve. Aprovimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit do të evidentohet me nënshkrim të DNPDP-së nga Zyrtari Kryesor Administrativ (ZKA) dhe Zyrtari Kryesor Financiar. Në (7) shtatë raste DNPDP-ja nuk ishte në dosjen e prokurimit dhe në (2) dy raste tjera ajo nuk ishte nënshkruar nga ZKA-ja dhe ZKF-ja për konstatimin e nevojave dhe fondeve. QKUK-ja e ka neglizhuar rëndësinë e DNPDP-së. Mungesa dhe mosnënshkrimi i saj tregon se proceset e prokurimit në start kanë mangësi të cilat reflektohen direkt në procesin e pagesave dhe në implementim jo efikas të kontratave. Si pasojë e kësaj mund të vjen deri te mungesa e fondeve dhe blerjet e pa autorizuara. Mungesa e përgatitjes së planit preliminar ka reflektuar në mangësitë e planit final. Mospërputhje e çmimeve të faturuara me ato të kontraktuara- Çmimet e faturuara duhet të jenë identike me ato të kontraktuara. Gjatë ekzaminimit të lëndës “Furnizim me material për fiziatri” në vlerë prej 4,937 €, kemi vërejtur që çmimet e faturuara të kompanisë fituese “KO-MED” nuk ishin identike me çmimet e kontraktuara. Sikur fatura të ishte paguar në bazë të çmimeve për njësi, atëherë vlera e faturës do të duhej të ishte 5,128.50 €, apo për 191.50 € më e shtrenjtë se vlera e kontratës. Në rastin e lartcekur nuk kishte mbi pagesë pasi që AK-ja kishte paguar vlerën totale të faturës, e cila ishte identike me vlerën e kontratës. Çmimet e

faturuara për njësi të kompanisë “KO-MED”, ishin plotësisht të njëjta me çmimet e ofruara të kompanisë “ATOM-MED”, e cila gjatë tenderimit ishte vlerësuar e pasuksesshme.

Kjo tregon se kontrollat e brendshme nuk kishin identifikuar këto dallime në çmime. Po ashtu ky është një sinjal se dy kompanitë e lartpërmendura mund të kishin qenë palë të ndërlidhura me rastin e pjesëmarrjes në këtë proces të prokurimit.

Mungon siguria e ekzekutimit - Në njoftimin për kontratën „Furnizim me pajisje për teknologjinë Informative - 6 lloje” AK si kusht për lidhjen e kontratës ka kërkuar sigurinë e ekzekutimit prej 10 % nga vlera e kontratës. Gjatë testimit të dosjes së tenderit të operatorëve fitues të cilët ishin shpërblyer me kontratë, kemi vërejtur se për dy llojet, kontrata është nënshkruar me operatorët fitues edhe pa sigurinë e ekzekutimit.

AK-ja nuk respekton kriteret që vetë i kishte vendosur- Në dosjen e tenderit “Furnizim me material dhe pajisje medicinale”, AK-ja kishte vendosur si kriter që OE fitues para publikimit për dhënien e kontratës të sjellë si dëshmi vërtetimin nga Gjykata Ekonomike, Administrata Tatimore dhe Korporata Energjetike e Kosovës, për të vërtetuar kryerjen e obligimeve. Nëse OE-ja si fitues dështon t’i dorëzojë këto dokumente, oferta e tij do të refuzohet dhe AK-ja do të vazhdojë me ofertuesin e renditur në vendin e dytë. Në të njëjtin tender, AK-ja ka kërkuar që OE-ja fitues, të ofrojë garanci një vjeçare për pajisjet/mallrat e ofruara. Garancioni u mungon dy OE-ve që ishin shpallur fitues të tenderit. Eliminimi i OE-së të përgjegjshëm me çmimin më të lirë- Sipas neneve 7.1 dhe 7.2, të LPP-së, AK-ja do t’i trajtojë OE-të në mënyrë të barabartë, pa diskriminim dhe do të veprojë në mënyrë transparente si dhe nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit, në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve.

Ne kemi gjetur se me rastin e vlerësimit të ofertave për tenderin „Demolimi, furnizimi dhe montimi me dritare në Gjinekologji”, AK-ja kishte eliminuar si të papërgjegjshme ofertën e OE „Vizion Project”, me vlerë 158.540 €, me arsyetimin se nuk i ka plotësuar kushtet e kërkuara me dosjen e tenderit. Sipas raportit të vlerësimit, OE-ja nuk posedonte referencat dhe kontratat për punë të ngjashme, të kryera në tri vitet e fundit. Gjatë testimit të dosjes së tenderit kemi vërejtur se ky OE, i posedonte dokumentet e lartcekura, të cilat ishin kërkuar edhe në dosjen e tenderit. AK-ja kishte lidhur kontratën me OE, i cili kishte ofertuar me çmim 159.450€, që ishte për 910 € më i shtrenjtë se oferta e eliminuar. Mosfurnizim i artikujve të kontraktuar- Kontrata „Furnizim me artikuj ushqimor”, në vlerë prej 48.492 € (në muaj) ishte lidhur në vitin 2011 dhe kishte vazhduar deri në korrik të vitit 2012. Ne analizuam nëse ishte përmbushur kontrata në tërësi dhe kemi gjetur se artikujt e mëposhtëm nuk ishin furnizuar asnjëherë.

Mospranimi i aparatit si donacion nga QKUK-ja-Te Kontrata „Furnizim me Reagensë” theksohet se përveç reagensëve që do t’i ofrojë sipas kontratës, operatori do t’i ofrojë si donacion QKUK-së edhe një aparat të avancuar për analiza biokimike “Analizatorin Imunoassay Diasorin Liaison” të tipit „Random Acces” me shpejtësi prej 100-140 teste në orë. Ky aparat kryen 85 lloje të ndryshme të testeve, njëkohësisht 15 lloje të testeve. Edhe pse aparati në fillim ishte pranuar nga ana e Shërbimit të Mirëmbajtjes së Pajisjeve Biomjekësore në QKUK, pas 4 muajve i njëjti aparat, pa ndonjë arsyetim, ishte kthyer sërish te OE, për shkak që nuk e kishte pranuar Instituti i Biokimisë. Pas diskutimit të kësaj çështje me menaxhmentin e QKUK-së ata janë zotuar se do ta pranojnë aparatin, sepse nga stafi i Institutit të Biokimisë nuk kishte ndonjë arsye bindëse për mospranimin e tij.

Vonesa në ekzekutimin e punëve dhe ofrimin e mallrave / shërbimeve- Përmbushja e kontratës duhet të jetë në përputhje me afatin e definuar në kontratë. QKUK-ja asnjëherë nuk kishte ndërmarrë ndonjë masë lidhur me aplikimin e gjobave, pavarësisht dispozitave të kontratës.

Ne kemi vërejtur se në 4 (katër) raste nuk ishin respektuar afatet për kryerjen e punëve apo të ofrimit të mallrave ose shërbimeve siç ishin paraparë me kontratë: Te Kontrata „Furnizim me pajisje dhe mbrojtjen e Aparateve Mjekësore” ka pasur 8 ditë vonesë në përmbushjen e kontratës në vlerë prej 1.182 €; te Kontrata „Servisimi i Autoklavit Gëting”, ka pasur 17 ditë vonesë në përmbushjen e kontratës në vlerë prej 8.295€; dhe në kontratën “Demolimi, furnizimi dhe montimi me dritare në Gjinekologji” në

vlerë prej 159,450€, afati për përfundimin e të gjitha punëve ishte 45 ditë. Kontrata ishte lidhur më 4.10.2012 dhe raporti i pranimit të punës ishte me datën 29.3.2013, që i bie se kontrata ishte realizuar me një vonesë prej 66 ditëve. Pas kësaj ai hapi diskutimin.

Ramiz Lladrovci- QKUK-ja ka mospërputhje të planit me ndarjen buxhetore të vitit për blerjet që kërkojnë proces të prokurimit. Në planin e prokurimit vlera e kontratave për furnizime dhe shërbime është 5,584,000€, ndërsa shuma e buxhetit të aprovuar ishte 4,996,430€, që do të thotë se QKUK-ja ka planifikuar të shpenzojë 587,570€ më shumë se sa mjetet e lejuara buxhetore; Prokurime të zhvilluara pa deklaratën e disponueshmërisë së fondeve; Shumica e kontratave në QKUK, janë me vlerë të vogël ose minimale. Në vitin 2012, QKUK-ja kishte nënshkruar 226 kontrata. Prej tyre 169 kontrata, apo 75% ishin me vlerë të vogël dhe minimale. Vlera totale e tyre ishte 395,245€. Planifikimi i dobët dhe vlerësimi jo i mirë i nevojave; Kërkesa emergjente nga njësitë kërkuuese për blerjen e artikujve gjatë vitit; dhe mos grumbullimi i kërkesave dhe zhvillimi i prokurimeve të ndara për blerjen e artikujve të njëjtë. Gabime të shumta në PVF, pse në fakt janë këto gabime, këto lëshime janë për shkak të paafetësisë së zyrtarëve apo si rezultat i menaxhimit jo të mirë të institucioneve shëndetësore?

Kryetari- Pyeti sa i përket Klinikës së Kirurgjisë Plastike, ku është në proces të buxhetit për vitin 2014?

Njazi Gashi, QKUK - Të gjeturat e ZAP-it janë të qëlluara për QKUK-në, këto të gjetura janë për shumë arsye e një nga këto është buxheti i vogël. Dobësi të shumta janë në fushën e prokurimit dhe kjo ka ndodh se para dy viteve i kemi pasur vetëm dy te punësuar që kanë punuar në prokurim, ndërsa tani i kemi 6 zyrtarë. Lëshimet kanë ardhur vetëm për shkak të mungesës së kuadrit adekuat.

Shumica e rekomandimeve të dhëna janë në zbatim e sipër, edhe pse për këtë duhet kohë me e gjatë. Ajo që ne tani jemi munduar të bëjmë është që të kemi prokurime afatgjata dhe vlera me të mëdha. Problem në vete paraqet edhe mungesa e interesimit të stafit për të marrë pjesë në tender qoftë në hapje apo në përzgjedhje të ofertuesit më serioz. Problem tjetër është hartimi i specifikave të tenderëve për aparaturat e ndryshme. Në QKUK ka probleme nga me të ndryshme, ngase aty ekziston një institucion prej 3000 te punësuarve. Ne tani i kemi ngritur shërbimet përbrenda vetë QKUK-së.

Lage Olofsson, auditor i përgjithshëm - Këtu nuk është problemi vetëm tek prokurimi. Problem në vete është tek inicimi i proceduarve për prokurim, pagesat dhe evidenca e tyre, kjo në fakt është një zinxhir i lëshimeve. Dizajni i prokurimit duhet të shikohet si i terë ky proces. Kjo i mbetet menaxhmentit të QKUK-së për ndarje të detyrave përbrenda vetë institucionit.

Ramiz Lladrovci- Caktimi i stafit të njëjte në proces të prokurimit, nuk duhet të jetë problem, sepse nuk është e thënë vetëm zyrtarë të prokurimit të merren me këtë çështje. Pra, të angazhoni anëtarë edhe nga departamentet tjera të MSH-së, për t'i ndihmuar Departamentit të Prokurimit.

5. Shqyrtimi i Raportit të Auditimit për sistemin e menaxhimit financiar dhe kontrolleve në Agjencinë Kosovare për Produkte Medicinale, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2012;

Kryetari – Tha se pasqyrat financiare, raporti nuk prezanton saktësinë e proceseve të ndodhura. Në të gjitha kategoritë e të hyrave kishte dallime të evidencave nga njësia raportuese. Përshtatja e specifikave të tenderit, furnizimi me telefon? Pse ka ndodhur kjo? Vlerësimi dhe pranimi i mallit - i njëjti person kishte bërë vlerësimin dhe pranimin e faturës për atë produkt. Rritja e koeficientit, varësisht nga angazhimi në punë! Kjo është në kundërshtim me ligjin. Regjistrimi i pasurisë – AKPM-ja nuk ka regjistrim të pasurisë. Natyra

e licencimit nuk përkon me veprimtarinë e tij- për këtë referojuni raportit. Lëshimi i licencës për import, pa pasur autorizim marketingu. Lëshimi i autorizimit pa certifikatë të ISO standarde. Çështje të tjera me autorizime për pajisje medicinale, kishte autorizime të anuluar dhe për të cilat nuk mbahen evidenca. Mungesa e raporteve nga banderolat. Konkluzioni i përgjithshëm thotë se çështjet e ngritura brenda këtij raporti kanë treguar se edhe menaxhimi financiar dhe menaxhimi i aktiviteteve operative brenda AKPM-së, kanë vend për zhvillim dhe përmirësim të mëtejshëm. Raportimet e brendshme kanë shumë mangësi dhe si të tilla nuk paraqesin bazë të mirë për vendimmarrje. Këto mangësi kanë ardhur si pasojë e moskoordinimit të mirë ndërmjet departamenteve. E gjithë kjo është përcjellë me informata të mangëta dhe mosshpalosje të duhura në raportin vjetor financiar. Ekzekutimi i buxhetit ka treguar se planifikimet nuk ishin të bazuara në analiza të qëndrueshme dhe mundësi reale të realizimit. Gjatë përpilimit të kërkesave buxhetore, duhet të merren parasysh të gjithë faktorët që mund të ndikojnë në realizimin e tij. Vëmendje të shtuar duhet ti kushtohet edhe dinamikës së realizimit të buxhetit. Duke konsideruar natyrën e aktiviteteve operative të Agjencisë, konsiderojmë se një bazë adekuate për menaxhimin e të dhënave është e domosdoshme. Menaxhmenti ka marrë disa hapa në këtë drejtim dhe ne i inkurajojmë që të vazhdojnë tutje këtë proces.

Afrim Hoti- Mospërputhje në mes çmimit të faturuar të derivateve dhe atij të Berzës-AKPM kishte paguar derivatet për ngrohje qendrore në bazë të çmimit të faturuar nga OE-jam, prej 1.25€/l derisa çmimi i berzës ishte 1.15€/l. Në këtë rast, për furnizimin me 5.000 litra kishte rezultuar me mbi pagesë prej 515€.

Arijanit Jakupi- UD- AKPM- Kam kërkuar raportet e auditimit të vitit paraprak dhe planet e veprimit. Në AKP nga ZAP-i, janë gjetur pasaktësi dhe janë marrë veprime konkrete. Është marrë vendim që të gjitha të hyrat të bëhen nga secili departament, në mënyrë vetjake Vlerësimi i pranimit të mallit nga i njëjti person - kjo është adresuar.

Regjistrimi i pasurisë- zyrtarja e regjistrimit të pasurisë nuk është më punëtore e AKPM-së dhe lidhur me këtë kemi kërkuar nga MAP-i që të lejojë plotësimin e kësaj pozite. Sa i përket licencimit - është hartuar UA për dhënien e licencave, pajisjen me produktet mendicinale-sepse ka pasur një problem te pajisjet dentale apo pajisje të tjera medicinale. Lëshimi i licencës pa autorizim marketingu- ju njoftoj se ka disa kategori të produkteve të cilat mund të jepen pa autorizim për marketing. Anulimi i autorizimeve –ka një regjistrim të çdo anulimi që bëhet, megjithatë kam marrë përsipër që të angazhoj një specialist për definimin e proceseve, të cilat ndodhin në AKPM për krijimin e një sistemi online të licencimit brenda agjencisë.

Ka pas mungese të emërimit të Komisionit nga Qeveria e Kosovës, me një vonesë të madhe kjo krijon një pritje të madhe të produkteve për licencim. Janë formuar 4 nënkomisione për evaluim të produkteve.

Sejti Tolaj- zyrtar kryesor financiar në AKPM, – Të hyrat - ekziston zyra e banderolave, mosbarazimi është krijuar për faktin se mbi 1 milion banderola janë shtypur në vitin 2011, por të hyrat janë inkasuar ë vitin 2012. Këtë nuk e ka përfshirë ZAP-i dhe ka krijuar diferencën. Në mungesë të paragon bllokave për banderola, derisa është furnizuar agjencia, ne kemi dhënë banderola se kemi lloje të ndryshme të unirefave për banderola. Këtë nuk e ka përfshirë auditori. Zyrtarja jonë barazohet më MSH-në lidhur me të hyrat dhe zyrtarja e MSH-së i merr raportet nga bankat. Raporti i auditorit për të hyra vetëm e ka cekë si moskoordinim në mes të departamenteve.

Lage Olofsson, auditor i përgjithshëm - Kjo është shumë e lehtë për tu shpalosur gjatë viteve. Ju si institucion nuk keni qenë të aftë të përshkruani këtë në mënyrën e duhur për ministrinë, parlamentin dhe këdo. Sot e sqaroni shumë mirë, por këtë është dashur të bëni me kohë.

Sejtë Tolaj – Çmimi i berzës dhe prokurimi - Kemi bërë planin për adresimin e rekomandimeve. Te çmimi i berzës është gabim i auditorit, kur flitet për mbi pagesë, sepse ne furnizohemi me derivate të naftës e jo me benzinë. Auditori ka shikuar çmimin në berzë të benzinës, jo të naftës. Specifikat teknike të telefonat- asnjë procedurë nuk është përmendur emri i produktit.

Ramiz Lladrovci - Pse nuk i keni dhënë komentet të auditorit i përgjithshëm, në afatin dy javorë. Pastaj, keni lidhur kontratë një ditë mbasi keni pranuar mallin, kjo është në kundërshtim me ligjin.

Sejtë Tolaj - Ne kemi dorëzuar planin e veprimit me komente të auditorit, por pse nuk janë përfshirë ato. Lidhur me pyetjen për lidhjen e kontratës pas pranimit të mallit, ky ka qenë një lëshim teknik.

Artan Venhari - Komentet e AKPM-së i kemi pranuar në plan veprimi e jo në draft raportin brenda afatit për komentim. Specifikat qojnë në një drejtim të caktuar dhe lidhur me këtë është pajtuar edhe AKPM-ja.

Muselj Haljilji - Ekziston mosrespektim i ligjit. Ju si person i autorizuar a keni marrë ndonjë proces ligjor? A ekziston sanksioni për ata njerëz? Menaxhimi me produkte medicinale, nuk dua të prejjudikoj. A ekziston një proces disiplinor lidhur me këto parregullsi?

Ferid Agani, ministër i shëndetësisë – Do t'i përgjigjemi rekomandimeve të Komisionit dhe do të shihni se çka konkretisht kemi ndërmarrë. Këtu ka edhe procese hetimore si drejtori i agjencisë, pastaj drejtori i licencave etj .

Isë Latifi - auditor i brendshëm-MSH- MSH-ja ka bërë planin e veprimit për adresim të rekomandimeve dhe është formuar komisioni për zbatim të këtyre rekomandimeve. Por çka është me rëndësi edhe ministri ka kërkuar nga NJAB-i që të mbikëqyrë zbatimin e rekomandimeve të ZAP-it. Vaksinat – është një kërkesë e ministrit që të vizitohen të gjitha qendrat e mjekësisë familjare. Duke ju falënderuar asaj se ka tepriçë të vaksinave. Të hyrat-monitrohen mirë, dorëzohen mirë, NJAB-i me përkrahje të ZAP-it, ka bërë auditim të brendshëm në disa institucioneve shëndetësore përkitazi me të hyrat vetjake. Ekziston kërkesa e ministrit që të mbikëqyrë zbatimin praktik të rekomandimeve në Pejë, në Gjakovë dhe në Prizren.

Ramiz Lladrovci- Auditori i brendshëm nuk ka përgjegjësi në zbatimin e rekomandimeve, por ajo është përgjegjësi e ministrit. Auditori i brendshëm ka për detyrë të mbikëqyrë rrezikshmërinë.

Ferid Agani, Ministër i shëndetësisë - Ministri shfrytëzon të gjitha kapacitetet për përmbushjen e obligimeve. Dhe kjo e gjitha në funksion të zbatimit të rekomandimeve.

Ramiz Lladrovci - Ministri mund të caktoj detyrë shtesë nga NJAB, por përgjegjësia e ministrit është të mbikëqyrë zbatimin e rekomandimeve dhe të raportojë para këtij Komisioni. Para Komisionit përgjegjës është ministri, stafi tjetër është për të ndihmuar ministrin, jo Komisionin.

6. Shqyrtimi i Raportit të Auditimit për sistemin e menaxhimit financiar dhe kontrolleve në Agjencinë Kosovare për Produkte Medicinale, për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2012

Kryetari - Ka një keqmenaxhim të këtij procesi. Mbeturinat ndahen fillimisht nga mbeturinat e

tjera të zakonshme (komunale) në vendin e gjenerimit të tyre dhe pastaj ndahen edhe nga njëra-tjetra. Pasi që të ndahen në bazë të vetive të tyre, ato duhet të vendosen në thasë, enë ose kontejnerë të ndarë sipas ngjyrave: të kuqe, të verdhë, të gjelbër dhe të zezë, varësisht sipas llojit. Ndarja e tyre sipas vetive bëhet për arsye se disa lloje të mbeturinave, duhet të trajtohen në mënyra të ndryshme dhe të përshtatshme. Mbledhja- mbeturinat mbledhen nga vendi ku është bërë ndarja e tyre dhe pastaj vendosen në vende të përkohshme magazinimi, gjithnjë duke përdorur rroba mbrojtëse dhe mjete transportuese të përshtatshme (karroca). Këto mjete duhet të përdoren vetëm për qëllim të transportit të mbeturinave. Magazinimi i mbeturinave bëhet në vende të posaçme, që i plotësojnë kushtet për magazinim të tyre, të cilat duhet të jenë të mbyllura, ku nuk ka qasje askush, përveç personit të autorizuar. Transportimi i mbeturinave nga vendet ku janë magazinuar deri në trajtimin përfundimtar- asgjësim, bëhet me mjete të cilat i plotësojnë kriteret mbi qarkullimin rrugor, kushtet higjienike, shëndetësore dhe mjedisore. Trajtimi-deponimi i tyre bëhet në pajisjet për sterilizim, furra për djegie (insineratorë) dhe groposje. Është e ndaluar që deponimi i tyre të bëhet në deponi të mbeturinave komunale dhe kjo gjë lejohet vetëm me leje të MMPH-së.

Ramiz Lladrovci – Sipas auditorit furrat nuk funksionojnë, mbeturinat hidhen dhe përzihen me mbeturina të zakonshme komunale dhe kjo paraqet rrezik për qytetarët. Lidhur me këtë raport kërkoj sqarim nga ZAP-i.

Artan Venhari- Raporti i ZAP-it thotë se furrat ekzistojnë, por nuk janë funksionale, sepse nuk i kanë plotësuar kriteret mjedisore. QKUK-ja nuk ka dhënë komente se janë furrat dhe se aplikohen. Ka dallim se secila nga qendrat rajonale i menaxhon mbeturinat. Spitali rajonal është spitali më i avancuar në krahasim me spitalet e tjera. Menaxhimi i mbeturinave është i rregulluar me UA. Institucionet private nuk janë pjesë e fushëveprimit të auditimit.

Valbona Dibra- Pyeti: A është problemi që MMPH-ja e ka ndaluar përdorimin e këtyre furrave apo si?

Ferid Agani -Furrat djegëse, funksionojnë në çdo spital shumë mirë dhe në këto furra digjen edhe materialet e sjella nga KFOR-i.

Nijazi Gashi- MMPH-ja ka dhënë rekomandim që ai insulator të mos përdoret. QKUK-ja i shkatërron mbetjet përpos atyre inorganike. Tani kemi rregullore lidhur me këtë, por kjo nuk është e mjaftueshme. MMPH-ja dhe MSH-ja duhet të nxjerrin një akt nënligjor, i cili rregullon menaxhimin e këtyre mbetjeve.

Ferid Agani – UA për menaxhimin e mbetjeve medicinale është në fazën përfundimtare. Kjo do të specifikojë obligimet e secilit institucion lidhur me këtë. Spitali i Prizrenit është institucioni më i avancuar shëndetësor, i cili bënë asgjësimin e mbetjeve medicinale, ka impiantin për sterilizimin e mbeturinave dhe hedhjen e tyre si mbeturina të rregullta. Kjo është forma më e avancuar e të pasurit furra djegëse. Po ashtu dua t'ia dorëzoj Komisionit përgjigjet e drejtorit të Spitalit të Prizrenit, lidhur me të gjeturat e ZAP-it.

Ramiz Lladrovci- Mbeturinat e Institucionet shëndetësore private- kush është përgjegjës për menaxhim të këtyre mbeturinave?

Ferid Agani- Kjo është përgjegjësi e Inspektoratit Shëndetësor.

\

Kryesuesi konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, njëzëri nxori këtë

Përfundim

Shqyrtimi i rekomandimeve për katër raportet e shqyrtuara në Komision, do të bëhet në mbledhjen e radhës të Komisionit.

7. Të ndryshme.

a).Përzgjedhja e auditorit të jashtëm, i cili do të bëjë auditimin e pasqyrave vjetore financiare të ZAP-it

Kryesuesi konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, njëzëri vendosi që Kryesisë së Kuvendit t'i

Rekomandojë

- 1. Të autorizohet Administrata e Kuvendit, përkatësisht Drejtoria për Prokurim në Administratën e Kuvendit, të bëjë përzgjedhjen e auditorit të jashtëm, për auditimin e pasqyrave vjetore financiare të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm, për vitin 2013.*
- 2. Lidhur me përzgjedhjen e Kompanisë audituese, Administrata e Kuvendit, përkatësisht Drejtoria e Prokurimit, duhet të njoftoj me raport me shkrim Komisionin për Mbikëqyrjen e Financave Publike.*
- 3. Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, me raport me shkrim do të njoftoj Kryesinë e Kuvendit.*

b). Përzgjedhja e auditorëve për auditimin e fushatës zgjedhore sipas Ligjit për financimin e subjekteve politike

Kryetari njoftoi anëtarët e Komisionit lidhur me përzgjedhjen e auditorëve për auditimin e fushatës zgjedhore, sipas Ligjit për financimin e subjekteve politike - kjo vetëm për njoftim sepse akoma nuk ka përfunduar procesi zgjedhor.

Kryesuesi konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, njëzëri nxori këtë

Përfundim

Autorizohet kryetari i Komisionit, që pasi të përfundoj procesi zgjedhor në Kosovë, ti rekomandoj kryesisë së Kuvendit, për të autorizuar Administratën e Kuvendit përkatësisht Drejtorinë e Prokurimit, që në bashkërendim me Komisionin për Mbikëqyrjen e Financave Publike, të bëjë përzgjedhjen e auditorëve, të cilët do të bëjnë auditimin e fushatës zgjedhore.

c) Mbledhja e radhës

Ramiz Lladrovci - Propozoj që mbledhja e Komisionit, e planifikuar për datën 27 nëntor 2013, të zhvendoset dhe mbahet më 25 nëntor 2013, kjo për shkak të festave të nëntorit.

Kryesuesi konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, njëzëri nxori këtë

Përfundim

Mbledhja e Komisionit e planifikuar për ditën e mërkurë, më 27 nëntor 2013, zhvendoset dhe do të mbahet më 25 nëntor 2013, në orën 10:00.

Mbledhja përfundoi në orën 13:15.
E përgatiti:
Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit

Ali Sadriu